



Republika e Kosovës
Република Косово / Republic of Kosovo
Qeveria / Влада/ Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Ministry of
Communities and Return*

Data: 10.09.2018 - 24.09.2018

Ministria për Komunitete dhe Kthim duke u bazuar ne Ligjin mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 , si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës shpall:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

Për plotësimin e vendit të lirë të punës në : Departamentin për Planifikim të Politikave dhe Analiza në MKK

Titulli i vendit të punës: Drejtor i Departamentit për Planifikim të Politikave dhe Analiza (1 vend pune)

Numri i referencës së vendit të punës: RP00071348

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës : Niveli drejtues 4

Koeficienti : 10

Kategoria e punësimit : e karrierës

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës

Përgjegjësitë mbikëqyrëse : Po

Raporton te : Sekretari i Përgjithshëm i MKK-së

Orari i punës : I plotë

Vendi i punës : Fushë Kosovë

Qëllimi i vendit të punës: Nën mbikqyrjen e drejtëpërdrejtë të Sekretarit të Përgjithshëm është përgjegjës për organizimin , koordinimin e aktiviteteve për kryerjen dhe përmbushjen e detyrave profesionale lidhur me punët e Departamentit për Planifikim të Politikave dhe Analiza në menyre sa më efikase .

Detyrat dhe përgjegjësitë

- 1.Udhëheq, koordinon dhe përgjigjet për punën e Departamentit;
2. Është përgjegjës për hartimin e politikave, monitorimin e zbatimit të këtyre politikave

dhe koordinimin e punës së MKK-së me Ministrinë tjera të linjës lidhur me këto politika ;

3. Ndihmon dhe këshillon në përcaktimin dhe vendosjen e prioriteteve strategjike të Ministrisë në pajtim me prioritetet e Qeverisë ;
4. Bënë hartimin e dokumenteve të politikave dhe planifikimit për MKK-në, strategjitë dhe planet e veprimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre, duke siguruar që këto dokumente të jenë në pajtim me politikat dhe prioritetet e Qeverisë;
5. Bënë vlerësimin e ndikimit të veprimeve të MKK-së (programeve dhe projekteve)
6. Analizon, vlerëson dhe monitoron zbatimin e legjislacionit në fuqi lidhur me komunitetet;
7. Kordinon aktivitetet me Ministrinë për Integritet Evropian (MIE) në kuadër të procesit të Integritet Evropian dhe detyrave e obligimeve që dalin nga ky proces;
8. Monitoron dhe raporton rezultatet dhe aktivitetet e departamenteve dhe agjencive në kuadër të ministrisë që lidhen me obligimet që dalin procesi I integritet evropian dhe dokumentet tjera strategjike të qeverisë së Kosovës.
9. Kordinon aktivitetet me MIE-në lidhur me shfrytëzimin efikas të fondeve dhe bashkëpunon në koordinimin dhe programimin e asistencës financiare dhe teknike të ofruar nga BE-ja.;
10. Ndërmerr të gjitha veprimet tjera të kërkuara nga Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm i MKK-së që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Planifikim të Politikave dhe Analiza.
11. Kordinon aktivitetet dhe udhëzon stafin e departamentit në kryerjen e detyrave të dhëna, kujdeset për vlerësimin periodik dhe vjetor të punës si dhe bënë vlerësimin e performancës së punës së stafit të Departamentit;
12. Drejtori i Departamentit i raporton rregullisht Sekretarit të Përgjithshëm për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi si dhe kërkon mbështetjen e tij/saj për pengesat që mund të has;
13. Sipas nevojës kryen dhe punë të tjera të cilat i përcakton Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministri.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim :

- Minimum shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, nga to katër (4) vite pozitë udhëheqëse.

Shkollimi i kërkuar :

- Diplome universitare – fakulteti juridik, ekonomik, shkencat shoqërore,

Shkathtësitë e kërkuara :

- Të jetë në gjendje të punoj nën presion, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë
- Njohja e gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe
- Njohuri pune në punët me kompjuter (Word, Excel, Access, Outlook, Internet)
- Njohja e gjuhës angleze apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj paraqet përparësi

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e MKK-së dhe tabelen e shpalljeve në MKK .

Paraqitja e kërkesave:

Formularët për aplikim mund të merren çdo ditë pune nga ora 09:00 deri ora 15:30, zyra nr.12 në lokalet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Fushë Kosovë (ndërtesa e Hekurudhës, pranë ndërtesës së Stacionit Policor të Trafikut Regional të Prishtinës) ose të tërhiqen nga ueb faqja e MKK-së ku është bërë edhe shpallja e rekrutimit në adresën : www.mkk-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për Burime Njerëzore të MKK-së nr.12 ose nëpërmjet të postës në adresën : Ish ndërtesa e Hekurudhës ,Sheshi Nëna Terezë , Fushë-Kosovë.
Për informata më të hollësishme kontaktoni në nr. e tel.038/200 16-544, 200 16-543, 200 16-537, 200 16-531.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet në vijim :

- 1. Diploma e përgatitjes shkollore.**
- 2. Fotokopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.**
- 3. Dëshmia mbi përvojën e punës.**
- 4. Rekomandimet dhe dokumentet shtesë nëse i posedon.**

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".